

**VENDIM QARKULLUES I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
TE SHOQERISE AKSIONARE
WEnerg SH.A.**

WEnerg SH.A. eshte nje shoqeri aksionare, themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, me seli ne Blv. "Deshmoret e Kombit", Twin Tower no. 1, Kati 7^{te}, 1001 Tirane, Shqiperi, regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me NIPT K92118019L (me poshte referuar si "**Shoqeria**" ose "**WEnerg**"). Administratori i Shoqerise eshte Z. Zalo KOKA.

RENDI I DITES:

1. Vendim ne miratimin e bilanceve dhe te raporteve vjetore financiare per vitin 2012.
2. Te ndryshme.

Ne perputhje me Nenin 9.11 te Statutit te Shoqerise ("**Statuti**"), Asambeja e Pergjithshme, mund te ndermarre çdo veprim nepermjet vendimeve qarkulluese pa qene e nevojshme per t'u mbledhur.

Vendim Nr. 1/2013

NJOFTIM per anetaret e Asamblese se Pergjithshme, e perbere nga sa me poshte:

- a. **CN'AIR SAS**, shoqeri e thjeshtuar anonime, themeluar sipas ligjeve te Frances, regjistruar ne Gjykatën Tregtare te Lionit ne France me regjistrimin Nr. 450 809 835 RCS Lyon, me 14.11.2003 me seli ne 2, rue André Bonin, 69004 Lyon, France (ketu e me poshte referuar si "**CN'Air**"), e perfaqesuar rregullisht nga Z, Mathieu BONNET, shtetas Francez, lindur me 28 Prill 1973, banues ne France, mbajtes i pasaportes me nr. 07AB55741, ne cilesine e tij si President i CN'AIR;

Dhe

- b. **Ylliad sh.p.k.**, nje shoqeri shqiptare me pergjegjesi te kufizuar, themeluar me 16.04.2009 dhe regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me 17.04.2009, me NIPT K91617013R, me seli ne Blv. "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Nr. 1, kati 7^{te}, 1001 Tirane, Shqiperi (ketu e me poshte referuar si "**Ylliad**"), perfaqesuar rregullisht nga Znj. Anita SHUSHKU, shtetase e Zelandes se Re, lindur me 24 Prill 1965, ne Shkoder, Shqiperi, banuese ne Rr. "Nikolla Tupe", Pall. 2/1, Ap. 19, Tirane, Shqiperi, mbajtese e pashaportes Nr. LA177276, ne cilesine e saj si Administratore e Ylliad.

Nga: **Zalo KOKA**
Administrator
WEnerg SH.A.

Data: 28.06.2013

VURI NE DUKJE SE:

- A. CN'AIR zoteron 51% te aksioneve te kapitalit te Shoqerise ;
- B. Ylliad sh.p.k. zoteron 49% te aksioneve te kapitalit te Shoqerise ;
- C. Ne perputhje me nenin 9 dhe 10 te Statutit te Shoqerise, Asambleja e Pergjithshme eshte organi kompetent vendimmarres i Shoqerise qe perbehet nga te gjitha aksionaret e Shoqerise;
- D. Ne perputhje me nenin 9 dhe 10 t Statutit te Shoqerise, mbledhja e pergjithshme kryhet ne menyre te rregullt
- E. Ne perputhje me nenin 9.6 te Statutit te Shoqerise, Asambleja e Pergjithshme miraton bilancet dhe raportet vjetore financiare per vitin e kaluar financiar
- F. Humbja neto e Shoqerise eshte 591 194,00 EURO (Pese qind e nentedhjet e nje mije e njeqind e nentedhjet e kater Euro). Nuk do te shperndahet asnje dividend per vitin financiar aktual;
- G. Ky vendim qarkullues eshte miratuar ne perputhje me nenet e Statutit te Shoqerise dhe ne respektim te plote me te gjitha dispozitat e ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar ("**Ligji Tregtar**").

PER SA ME POSHTE, anetaret e Asamblese se Pergjithshme VENDOSEN:

1. Te miratojne bilancet dhe raportet financiare per vitin 2012, bashkengjitur ketij vendimi.
2. Humbja neto e Shoqerise eshte 591 194,00 EURO (Pese qind e nentedhjet e nje mije e njeqind e nentedhjet e kater Euro); prandaj te mos shperndahet asnje dividend per vitin 2011. Kjo humbje do te ekuilibrohet me fitimin e viteve pasardhes.
3. Te autorizoj Administratorin e Shoqerise, Z. Zalo KOKA, te ekzekutoje dhe te dorezoje ne emer te Shoqerise, cdo dokument te nevojshem per te zbatuar kete vendim dhe ne pergjithesi per te bere cdo gje te nevojshme per te permbushur dhe per ta bere ate te efektshem.

Ju lutem te votoni duke nenshkuar me poshte dhe te ktheni nje kopje te skanuar te ketij dokumenti te Znj. Anita Shushku, ashushku@wenerg.org, Drejtoreshe prane WEnerg Sh.A, me seli ne Blvd. "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake Nr. 2, Kati 13^{te}, Tirane, Shqiperi, dhe te percillni dy kopje origjinale me email.

(HAPESIRE E FAQES E LENE QELLIMISHT BOSH)

Anetaret e Asamblese se Pergjithshme votuan si me poshte per vendimet e propozuara ne kete Vendim Qarkullues te dates 28 Qershor 2013.

VOTIMI:

Vendim i miratuar:

(firmosur)

.....
Per CN'AIR: Mathieu BONNET

Vendi Data:

CN'AIR
2 rue André Bonin
69316 LYON Cedex 04
Tél. 04 72 00 18 22 - Fax 04 72 10 66 43

Vendim i refuzuar:

.....

Per CN'AIR: Mathieu BONNET

Vendi Data:

Vendim i miratuar:

(firmosur)

.....
Per Ylliad: Anita SHUSHKU

Vendi Data:



Vendim i refuzuar:

.....

Per Ylliad: Anita SHUSHKU

Vendi Data:

Emertimi dhe Forma ligjore

WENERG SH.A

NIPT -i

K92118019L

Adresa e Selise

KULLAT BINJAKE, KULLA NR.1

TIRANE

Data e krijimit

18.09.2009

Nr. i Regjistrit Tregetar


Veprimtaria Kryesore

PLANIFIKIM, PROJEKTIM, FINANCIM NDERTIM
TE HIDROCENTRALIT "DARDHA" NE PUKE

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr.2 dhe
Ligjit Nr. 9228 Date 29.04.2004 Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare)

Viti 2012

Jalo Koka


Armando Fejtoshaj


Pasqyra Financiare jane individuale
Pasqyra Financiare jane te konsoliduara
Pasqyra Financiare jane te shprehura ne
Pasqyra Financiare jane te rumbullakosura ne

Po
Jo
Leke
Leke

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare

Nga 01.01.2012

Deri 31.12.2012

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare

27.04.2013


PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2012

Nr	A K T I V E T	Shenime	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
I	AKTIVET AFATSHKURTRA		180,969,951	129,250,654
	1 Aktivet monetare	4	878,250	20,241,985
	> Banka	4/1	877,050	20,241,985
	> Arka	4/2	1,200	0
	2 Derivative dhe aktive te mbajtura per tregtim			
	3 Aktive te tjera financiare afatshkurtra	5	179,443,934	83,913,680
	> Kliente	5/1	36,231,254	0
	> Debitore, Kreditore te tjere	5/2	1,731,088	17,480,182
	> Tatim mbi fitimin	5/3	224,000	84,000
	> Tvsh	5/4	120,868,692	49,947,770
	> TVSH per tu rimbursuar	5/5	14,964,417	16,221,348
	> Tatim ne burim derdhur teper	5/6	5,407,116	0
	> Te tjera	5/7	17,367	180,380
	4 Inventari		0	0
	> Lendet e para		0	0
	> Inventari lmet		0	0
	> Produkte te gatshme		0	0
	> Mallra per rishitje		0	0
	> Parapagesa per furnizime		0	0
	5 Aktive biologjike afatshkurtra			
	6 Aktive afatshkurtra te mbajtura per rishitje			
	7 Parapagime dhe shpenzime te shtyra	6	647,767	25,094,989
	> Shpenzime te periudhave te ardhshme		0	0
	> Parapagime per punimet per tu kryer		647,767	25,094,989
II	AKTIVET AFATGJATA		992,418,168	893,442,296
	1 Investimet financiare afatgjata			
	2 Aktive afatgjata materiale	7	992,075,255	3,688,740
	> Toka		0	0
	> Ndertesa	7/1	676,267,096	0
	> Makineri dhe paisje	7/2	314,939,004	3,688,740
	> Aktive tjera afat gjata materiale	7/3	869,155	0
	3 Ativet biologjike afatgjata		0	0
	4 Aktive afatgjata jo materiale	7/4	342,913	403,427
	5 Kapitali aksioner i pa paguar			
	6 Aktive te tjera afatgjata		0	889,350,129
	Ndertesa ne proces		0	271,301,129
	Makineri dhe pajisje ne proces		0	618,049,000
	TOTALI AKTIVEVE (I+II)		1,173,388,119	1,022,692,950



PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2012


Nr	PASIVET DHE KAPITALI	Shenime	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
I	PASIVET AFATSHKURTERA		172,705,914	177,036,378
1	Derivativet			
2	Huamarjet	8	116,248,884	34,816,970
	> Overdraftet bankare	8/1	70,291,878	0
	> Huamarje afat shkuatra	8/2	45,957,006	34,816,970
3	Huat dhe parapagimet	9	56,457,030	142,219,408
	> Te pagushme ndaj furnitoreve	9/1	51,220,041	95,612,641
	> Te pagushme ndaj punonjesve	9/2	307,233	
	> Detyrime per Sigurime Shoq. Shend.	9/3	165,114	146,814
	> Detyrime tatimore per TAP-in	9/4	84,714	80,638
	> Detyrime tatimore per Tatim Fitimin		0	
	> Detyrime tatimore per Tvsh-ne		0	
	> Detyrime tatimore per Tatimin ne Burim	9/5	172,098	69,465
	> Te tjera detyrime ndaj shtetit	9/6	1,418,737	
	> Te drejta e detyrime ndaj ortakeve			
	> Debitore dhe Kreditore te tjere	9/7	3,089,093	46,309,850
4	Grantet dhe te ardhurat e shtyra		0	0
5	Provizionet afatshkurtra			
II	PASIVET AFATGJATA		1,102,045,041	867,517,359
1	Huat afatgjata	10	512,417,778	550,085,502
	> Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	10/1	512,417,778	550,085,502
	> Bono te konvertueshme			
2	Huamarje te tjera afatgjata	10/2	589,627,263	317,431,857
3	Grantet dhe te ardhurat e shtyra			
4	Provizionet afatgjata			
	TOTALI PASIVEVE (I+II)		1,274,750,955	1,044,553,737
III	KAPITALI		-101,362,836	-21,860,787
1	Aksionet e pakices (PF te konsoliduara)			
2	Kapitali aksionereve te shoq.meme (PF te kons.)			
3	Kapitali aksionar	11	4,000,000	2,000,000
4	Primi aksionit			
5	Njesite ose aksionet e thesarit (Negative)			
6	Rezervat statutore		0	0
7	Rezervat ligjore		0	0
8	Rezervat e tjera		0	0
9	Fitimet e pa shperndara		-23,860,787	-17,743,389
10	Fitimi (Humbja) e vitit financiar		-81,502,049	-6,117,398
	TOTALI PASIVEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)		1,173,388,119	1,022,692,950



Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve 2012

(Bazuar ne klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyres)

Nr	Pershkrimi i Elementeve		Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
1	Shitjet neto	12	48,989,870	0
2	Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit	13	2,773,377	
3	Ndrysh.ne invent.prod.gatshme e prodhimit ne proces		0	0
4	Materialet e konsumuara	14	2,521,281	0
5	Kosto e punes	15	12,359,112	0
	<i>Pagat e personelit</i>	16	10,979,662	0
	<i>Shpenzimet per sigurime shoqerore e shendetesore</i>	17	1,379,450	0
6	Amortizimet dhe zhvlresimet	18	23,238,437	0
7	Shpenzime te tjera	19	41,021,222	7,822,481
8	Totali shpenzimeve (shumat 4 - 7)	20	79,140,052	7,822,481
9	Fitimi (humbja) nga veprimtarite e kryesore (1+2+/-3-8)	21	-27,376,805	-7,822,481
10	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njesite e kontrolluara		0	0
11	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesemarrjet		0	0
12	Te ardhurat dhe shpenzimet financiare	22	-54,125,244	1,705,083
	121.0 <i>Te ardh.e shpenz. financ. nga inves. te tjera financ. afatgjata</i>			
	122 <i>Te ardhurat dhe shpenzimet nga int.+komisione bankare</i>	23	-54,564,241	-517,148
	123 <i>Fitimet (Humbjet) nga kursi kembimit</i>	24	409,074	2,222,231
	124 <i>Te ardhura dhe shpenzime te tjera</i>	25	29,923	0
13	Totali i te Ardhurave dhe Shpenzimeve financiare	26	-54,125,244	1,705,083
14	Fitimi (humbja) para tatimit (9 +/- 13)	27	-81,502,049	-6,117,398
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	28	0	0
16	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14 - 15)	29	-81,502,049	-6,117,398
17	Elementet e pasqyrave te konsoliduara			



Pasqyra e Fluksit Monetar - Metoda Indirekte 2012

Nr	Pasqyra e fluksit monetar - Metoda Indirekte	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
	Fluksi i parave nga veprimtaria e shfrytezimit	-215,109,022	152,394,574
	Fitimi para tatimit	-81,502,049	-6,117,398
	Rregullime per :	23,238,437	0
	Amortizimin	23,238,437	0
	Humbje nga kembimet valutore	0	0
	Te ardhura nga Investimet	0	0
	Shpenzime per interesa	0	0
	Rritje/renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme nga aktiviteti, si dhe kerkesave te arketueshme te tjera	-71,083,032	-92,604,389
	Rritje/renie ne Tepricen e inventarit	0	160,754,616
	Rritje/renie ne tepricen e detyrimeve ,per tu paguar nga aktiviteti	-85,762,378	90,361,745
	MM te perfituara nga aktivitetet	0	0
	Interesi i paguar	0	0
	Tatim mbi fitimin i paguar (Ilogaritur)	0	0
	<i>MM neto nga aktivitetet e shfrytezimit</i>		0
	Fluksi monetar nga veprimtarite investuese	-122,214,309	-770,354,776
	Blerja e njesisese kontrolluar X minus parate e Arketuara	0	0
	Blerja e aktiveve afatgjata materiale	-122,214,309	-770,354,776
	Te ardhura nga shitja e paisjeve	0	0
	Interesi i arketuar	0	0
	Dividentet e arketuar	0	0
	<i>MM neto te perdoruara ne veprimtarite investuese</i>		
	Fluksi monetar nga aktivitetet financiare	317,959,596	631,443,165
	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner	2,000,000	
	Te ardhura nga huamarrje afatgjata	315,959,596	631,443,165
	Pagesat e detyrimeve te qerese financiare	0	
	Dividente te paguar	0	
	<i>MM neto e perdorur ne veprimtarite Financiare</i>		
	Rritja/Renia neto e mjeteve monetare	-19,363,735	13,482,963
	Mjetet monetare ne fillim te periudhes kontabel	20,241,985	6,759,022
	Mjetet monetare ne fund te periudhes kontabel	878,250	20,241,985



WENERG SHA

Ne Leke

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital 2012**Nje pasqyre e pa Konsoliduar**

		Kapitali aksionar	Primi aksionit	Aksione thesari	Rezerva stat. ligjore	Fitimi pashperndare	TOTALI
I	pozicioni me 31 dhjetor 2010						0
A	Efekt ndryshimeve ne politikat kontabel						0
B	Pozicioni i rregulluar						0
1	Fitimi neto per periudhen kontabel						0
2	Dividentet e paguar						0
3	Rritja rezerves kapitalit						0
4	Emetimi aksioneve						0
II	pozicioni me 31 dhjetor 2011	2,000,000	0	0	0	-23,860,787	-21,860,787
1	Fitimi neto per periudhen kontabel						
2	Dividentet e paguar						-81,502,049
3	Emetimi kapitali aksionar	2,000,000				0	2,000,000
4	Aksione te thesari te riblera						
III	pozicioni me 31 dhjetor 2012	4,000,000	0	0	0	-105,362,836	-101,362,836



Pasqyrat Financiare 2012

Informacion i pergjithshem per Shoqerine

Shoqeria "WEnerg sh.a", eshte rregjistruar prane QKR me date 18.09.2009.

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 " per Tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2012 eshte Planifikim, projektim, financim ndertim te Hidrocentralit " Dardha"ne Puke si dhe Prodhim energji elektrike.

Kaptali themeltar eshte 4.000.000 lekë.

Administrator eshte Z. Zalo Koka.

Bazat e pergatitjes së pasqyrave

2.1 Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare janë pergatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK). Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi Fitimin", paragrafi 4, Shoqëria ka zgjedhur të mos kontabilizojë tatimet e shtyra në pasqyrat financiare për vitin që mbyllet deri më 31 dhjetor 2012.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë pergatitur bazuar në koston historike.

2.2 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.3 Vlerësime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrjnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat të paraqitura në pasqyrat financiare.



Pasqyrat Financiare 2012

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas të Bankes së Shqipërisë me 31.12.2012 dhe 31.12.2011 ka qenë respektivisht si me poshtë:

	2012	2011
1 Euro	139,59	138,93
1 USD	105,85	107,54

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (Mjete monetare)

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshtirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij

WENERG SH.A



Pasqyrat Financiare 2012

financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshire koston e transaksioneve.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale. Kuotat klasifikohen si kapitale.

3.3 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



Pasqyrat Financiare 2012

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Amortizimi për vitin aktual llogaritet si më poshtë:

Aktive	Përqindja	Menyra
Ndertime	2,86%	
Instalime	2,86%	
Makineri e pajisje	5%	
Pajisje elektrike	6,67%	Lineare
Mjete Transporti	20%	
Pajisje zyrash	20%	
Pajisje informatike	25%	
Te tjera AAM	20%	

3.4 Zhvlerësimi

i. Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, kur Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.



Pasqyrat Financiare 2012

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet llogarisë fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara gjatë vitit.

4. Mjete monetare në banke dhe në arke

	<u>31.12.2012</u>	<u>31.12.2011</u>
Llogari bankare	877,050	20,241,985
Arka	1,200	-
	<u>878,250</u>	<u>20,241,985</u>

Tepricat e llogarive bankare janë të kuadruara, ato përputhen me shumën e ekstrakteve të bankave me 31.12.2012.

Gjendja e eurove paraqitet e konvertuar me kursin e Bankes së Shqipërisë në dt.31.12.2012.

5. Kërkesa për Arketim

	<u>31.12.2012</u>	<u>31.12.2011</u>
Kërkesa për arketim	179,443,934	83,913,680
	<u>179,443,934</u>	<u>83,913,680</u>

Analitikisht:

	<u>31.12.2012</u>	<u>31.12.2011</u>
Kërkesa të arketueshme	36,231,254	-
Te tjera të arketueshme	1,731,088	-
Tatim fitimi	224,000	84,000
TVSH	120,868,692	49,947,770
Te drejta ndaj të tjerëve	14,964,417	17,480,182
Te tjera	5,424,483	16,401,728
	<u>179,443,934</u>	<u>83,913,680</u>



Pasqyrat Financiare 2012

Shuma e paraqitur ne zerin "Kerkesa te arketueshme" per 36.231.254 leke paraqet vleren e klientit KESH Sha te mbetur pa likujduar ne fund te vitit.

Shuma e paraqitur ne llogarine "Kerkesa te tjera per tu arketuar" ne shumen 1.731.088 leke paraqet te drejten per tu arketuar nga shoqeria Truen Shpk per 1.214.333 leke, garancine e koncensionit per 500.000 leke si dhe interesa aktive te llogaritura ne shumen 16.755 leke..

Shuma e paraqitur ne TVSH ne vleren 120.868.692 leke perfaqeson tepricen e TVSH kreditore per blerjet e realizuara deri me 31.12.2012.

Shuma e paraqitur ne postin "TVSH per tu rimbursuar" ne vleren 14.964.417 leke paraqet shumen e TVSH-se per tu rimbursuar pas kontrollit te kryer nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane.

Ne postin "Te drejta dhe detyrime ndaj te treteve" ne shumen 5.424.483 leke paraqet;

- Tatim ne burim i mbipaguar ne shumen 5.407.116 leke
- Te tjere ne shumen 17.367 leke.

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit eshte ne vleren 0 leke:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Inventari		
(i) Lëndët e para	-	-
(ii) Inventar i imet	-	-
(iii) Produkte të gatshme	-	-
(iv) Mallra për rishitje	-	-
(v) Parapagesat për furnizime	-	-
Shuma	-	-

6. Parapagime dhe shpenzime te shtyra:

Per vitin 2012 jane ne vlere 647.767 leke te cilat paraqesin parapagimet per siguracionet e aseteteve te shoqerise.

7. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjate vitit 2012 shoqeria ka blera aktive afatgjata si ne ndertese ashtu dhe ne makineri e pajisje si me poshte:

1. Ndertesa	185.066.021 leke
2. Instalime te pergjithshme ne ndertese	491.201.075 leke
3. Makineri dhe pajisje	312.069.984 leke
4. Mjete transporti	2.869.020 leke
5. Pajisje komp. Mobilje e tjera	869.155 leke
6. Aktive afatgjata jomateriale	342.913 leke
TOTALI	992.418.168 LEKE

Aktivt afatgjata jane paraqitur me vleren e tyre neto duke zbritur amortizimin e akumuluar deri me 31.12.2012.

8. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

WENERG SH.A



Pasqyrat Financiare 2012

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fund te ushtrimit kontabel 2012 jane ne vleren 116.248.884 leke te cilat perfaqesojne vleren e Overdraftit te marra prane Bankes Societe Generale per shumen 70.291.878 leke si dhe pjeses se principalit te huase afatgjate dhe te interesit pasiv te llogaritur qe do te paguhen gjate vitit 2013 ne shumen 45.957.006 leke.

9. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2012 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Huate dhe parapagimet		
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	51,220,041	95,612,641
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	307,233	0
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore	1,840,663	296,917
(iv) Hua të tjera Ortake	0	0
(v) Debitore dhe kreditore te tjere	3,089,093	46,309,850
Shuma	56,457,030	142,219,408

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht. Bashkengjitur lista e furnitoreve.

"Detyrimet tatimore+sig.shoqerore" perfaqesojne detyrimin per :

1. Sigurimet shoqerore per 165.114 leke,
2. TAP ne vleren 84.714 leke,
3. Tatim ne burim ne vleren 172.098 leke
4. Detyrime akt kontrolli ne shumen 1.418.737 leke.

10. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2012 ne shumen 1.102.045.041 leke perbehen nga:

- a. Huamarrje nga banka Popullore ne shumen 512.417.778 leke perfaqeson pjesen e principalit te huase ndaj bankes qe do te paguhet pas vitin 2013.
- b. Huamarrje nga shoqeria meme CNR Air ne shumen 589.627.263 leke.

11.

Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte 4.000.000 leke. Gjate ushtrimit kontabel 2012 ka rritje ne kapitalin e rregjistruar te shoqerise me 2.000.000 leke.

12. Fitimi (humbja) e vitit financiar

- Te ardhurat

WENERG SH.A



Pasqyrat Financiare 2012

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2011
Te ardhura nga shitja e produkteve	48.989.870	-
Te ardhura nga kryerja e sherbimeve (punime)	-	-
Te ardhura nga shitja e mallrave	-	-
Te ardhura te tjera	2.773.377	-
Shuma	51.763.247	-

Gjate vitit 2012 shoqeria Wenerg Sha ka filluar prodhimin e energjise elektrike ne muajin Maj 2012. Vlera totale e shitjeve te realizuara per vitin 2012 eshte 48.989.870 leke.

Te ardhura te tjera ne Shumen 2.773.377 leke perfaqeson rivleresim nga Inspektori I Kontrollit te Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane per shitje te materialeve gjendje te Shoqerise.

Shifra e afarizmit te prodhimit te realizuar qe rezulton ne bilanc nuk perputhet me shifren e afarizmit ne SI te TVSH prane Drejtorise Rajonale Tatimore per vleren 2.773.377 leke shume kjo e pasqyruar dhe ne bilanc ne zerin Te ardhura te Tjera, shume e cila eshte rivleresim I kontrollit tatimor te ushtruar prane shoqerise.

▪ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme.

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2012 jane treguar ne pasqyren perkatese.

▪ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)	77,257	-
Shpenzimet per interesat dhe komisionet bankare	(54,641,498)	(517,148)
Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)	1,661,915	2,222,231
Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)	(1,252,841)	-
Te ardhura dhe shpenzime te tjera 754	29,923	-
Shuma	(54,125,244)	1,705,083

13. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2012 dhe 2011 jane si vijon:




Pasqyrat Financiare 2012

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2011
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	(81,502,049)	(6,117,397)
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	70,863,559	
1 Amortizime teje normave fiskale		
2 Shpezime pritje e dhurime teje kufirit tatimor		
3 Gjoha,penalitetet,demshperblime	17,842,661	
4 Provizione qe nuk njihen		
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	53,020,898	
6 Te tjera-materiale jashte perdorimit(pa miratim)		
7 Paga me Cash		
III PJESA E HUMBES SE MBARTUR(-)		
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	(10,638,490)	(6,117,397)
V Shpenzimi i tatim fitimit-10%	-	(611,740)
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	(81,502,049)	(5,505,657)

14. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

WENERG SH.A



RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare te Shoqerise "WEnerg" sha

Drejtuar:

ASAMBLESE SE AKSIONEREVE TE SHOQERISE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë WEnerg sha (më poshtë "Shoqëria") që përmbajnë bilancin kontabël më datë 31 Dhjetor 2012 si dhe pasqyrën përkatëse të të ardhurave dhe shpenzimeve për këtë ushtrim, pasqyrën e fluksit të parase dhe pasqyrën e ndryshimeve të kapitaleve të veta, dhe të tjera shënime sqaruese.

Përgjegjësitë e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabile; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabile të arsyeshme për rrethanat financiare.

Përgjegjësitë e Audituesit të Pavarur

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tone në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të keq-deklarimeve materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e çmuarjeve kontabile të kryera nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare të Shoqërisë "WEnerg" sha japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2012 si dhe të rezultateve të aktivitetit të saj për ushtrimin e mbyllur më këtë datë në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit.

ILD-99 Audit shpk

Diana YLLI (Golemi)

Eksperte Kontabile e Regjistruar



Tirane, me 29 Prill 2013